



NGO - NETWORK OF PEACE MOVEMENT(NOPM)

Kamenicë, Kosovë

Shpallje për

Konsulent/Trajner Lokal

Projekti që financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë përmes projektit “Skema e granteve për nismat e avokimit nga organizatat me bazë në komunitet” – i zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), që do të implementohet direkt nga OJQ “Network of Peace Movement” (NOPM), i cili do të fillojë së zbatuari nga periudha 01 Nëntor, 2016 – 30 Shtator, 2017, në komunën e Kamenicës, Kosovë.

Prandaj, OJQ - NOPM në kuadër të grantit: Rritja dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje dhe politike bërje duke avokuar tek autoritet komunale për hartimin e politikave lokale, lehtësimin e debateve dhe dëgjimeve publike si dhe në ngritjen e kapaciteteve të komiteteve këshillëdhënës, të rinjve, grupit të grave, komuniteteve dhe këshillave të fshatrave për pjesëmarrje në vendim-marrje dhe politikë bërje shpall konkurs për pozitë **Konsulentit/Trajner Lokal**:

Komponentët kryesorë të programit të NOPM-së janë si në vijim:

- Përmirësimi i pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje dhe avokim në politikë bërje në komunë
- Hartimi dhe moderimi i politikave lokale tek autoritet lokale në komunë e Kamenicës
- Ngritja e kapaciteteve të komiteteve këshillëdhënës komunale, si dhe lehtësimi i debateve dhe dëgjimeve publike
- Vetëdijësimi i komiteteve këshillëdhënës, me fokus të veçantë: grupeve të grave, të rinjve, komuniteteve dhe këshillave të fshatrave për pjesëmarrje në vendim-marrje dhe politikë bërje në komunë
- Pjesëmarrja e të gjithë qytetarëve e të gjitha kombësive që jetojnë në komunën e Kamenicës, duke përfshirë kategoritë si gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe qytetarët e pjesëve rurale.

Shërbimi për këtë konsullencë kërkohet të angazhohet nga periudha 01 Nëntor, 2016 – 30 Shtator, 2017. Kandidatët e suksesshëm do të ftohen në listën e ngushtë dhe ditë të punës do të shpërndahet brenda dymbëdhjetë (12) muajve të kohëzgjatjes së projektit.

Ju lutem dërgoni aplikacionet e juaja (CV-në dhe letrën motivuese) në gjuhën Angleze apo Shqipe dhe/apo Serbisht me Emrin dhe Mbiemrin e kandidatit si dhe pozitën e cituar në Subjectline: Consultant/Local Trainer, deri më 30 Tetor, 2016, ora 17:00 p.m, përmes e-

mailit:ngo.nopm@gmail.com, kontaktimi përmes formave të tjera të komunikimit nuk do të merret parasysh.

Kandidatët të cilët përmbushin kërkesat minimale të cilat janë të paraqitura në shpallje do të ftohen në intervistë. Ju lutem vini re se aplikacionet e pranuar pas afatit nuk do të konsiderohen.

Për më shumë informata ju lutem shih. Termat e Referencës:

OJQ - NOPM ofron mundësi të barabarta të punësimit dhe inkurajon kandidatët qëi takojnë komunitetit jo-shumicë, personave me aftësi të kufizuara si dhe kandidatet femra për të aplikuar.

TERMAT E REFERENCËS (TeR)

Lloji i shërbimit të kërkuar: Konsulent/Trajner lokal

Shuma total e ditëve të punës: 14

Periudha e punës: 01 Nëntor, 2016 – 30 Shtator, 2017 (ditët e punës janë të shpërndara gjatë kësaj periudhe)

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Të ngritë dhe përmirësoj pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe politike bërje duke avokuar tek autoritet komunale për hartimin e politikave lokale, lehtësimin e debateve dhe dëgjimeve publike si dhe në ngritjen e kapaciteteve të komiteteve këshillëdhënës, të rinjve, grupit të grave, komuniteteve dhe këshillave të fshatrave për pjesëmarrje në vendim-marrje dhe politikë bërje.

Komponentët kryesore të programit të NOPM-së janë si në vijim:

- Përmirësimi i pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje dhe avokim në politikë bërje në komunë
- Hartimi dhe moderimi i politikave lokale tek autoritet lokale në komunë e Kamenicës
- Ngritja e kapaciteteve të komiteteve këshillëdhënës komunale, si dhe lehtësimi i debateve dhe dëgjimeve publike
- Vetëdijësimi i komiteteve këshillëdhënës, me fokus të veçantë: grupeve të grave, të rinjve, komuniteteve dhe këshillave të fshatrave për pjesëmarrje në vendim-marrje dhe politikë bërje në komunë
- Pjesëmarrja e të gjithë qytetarëve e të gjitha kombësive që jetojnë në komunën e Kamenicës, duke përfshirë kategoritë si gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe qytetarët e pjesëve rurale.

Projekti do të financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë përmes projektit “Skema e granteve për nismat e avokimit nga organizatat me bazë në komunitet” – i zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), dhe implementohet direkt nga OJQ NOPM, i

cili do të filloj së zbatuari nga periudha **01 Nëntor, 2016 – 30 Shtator, 2017**, në komunën e Kamenicës.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT E KONSULENTIT/TRAJNERIT LOKAL

Shërbimet të cilat duhet të ofrohen nga konsulenti/trajneri lokal për OJQ-në NOPM për komunën e Kamenicës, më konkretisht duhet të sigurohet ekspertiza si në vijim:

- Këshillon dhe asiston zyrtarët komunal, qytetarët dhe OJQ-të, lidhur me Komunitetin Komunal për Iniciativa, si dhe t'i sigurohet edhe plani i veprimit për qytetarin aktive në komunë
- Organizon punëtori me autoritetet komunale qytetarët dhe OJQ-të mbi hartimin e planit të veprimit të Komitetit Komunal për Iniciativa si dhe mbi hartimin e planeve të punës për vitin 2017, raportet vjetore të komiteteve konsultative, si dhe për planifikim të investimeve kapitale, etj
- Përgatitë materialin trajnues dhe organizon trajnime në shkolla mbi pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe politikë bërje
- Organizon punëtori, trajnon dhe fasiliton zyrtarët komunal, qytetarët dhe anëtarët e shoqërisë civile në ndërgjegjësimin e qytetareve mbi demokracinë e drejtpërdrejtë, qeverisjen e hapur, pjesëmarrjen efektive në proceset e vendim-marrjes dhe politik bërjes, si dhe ngritjen e kapaciteteve e komiteteve konsultative të këshillave të fshatrave
- Ngrit, fasiliton/lehtëson aktivitetet avokuese, merr pjesë në takime publike, konsultime publike dhe dialogu ndërmjet qytetareve/shoqërisë civile dhe autoriteteve komunale
- Organizon debat publike lidhur me avokim, lobim dhe komunikim mbi rritjen e pjesëmarrjes së publike në vendim-marrje, politike-bërje dhe avokim për temën mbi çështje të interesit në përgjithësi si p.sh në arsim (në shkollë me nxënësit), shëndetësi, përfshirjen gjinor, përfshirjen sociale (banim social) dhe të drejtat e njeriut
- Organizon takime në kuadër të aktiviteteve të parapara me këshillat e fshatrave/lokaliteteve për identifikimin e nevojave të komunitetit dhe grupeve lokale të interesit
- Organizon takime me vendimmarrësit e nivelit lokal (ekzekutivin dhe legjislativin) për elaborimin e nevojave në propozime konkrete lidhur me planin e Veprimit të Komitetit për Iniciativa.
- Bën lehtësimin dhe bashkë-moderimi e takimeve e dy takimeve publike me kryetarin e komunës
- Organizon, monitoron dhe kryen takime avokues me komunën me qëllimi të nevojave të Komitetit Komunal për Iniciativa, si dhe me këshillat e fshatrave lidhur me përgjegjësit dhe sfidat e tyre
- Përgatit raporte dhe dërgon tek personeli i organizatës NOPM pas çdo aktivitet të kryer ne terren (kryesisht raporton një ditë pas aktivitetit), si dhe raporton për të gjitha të gjeturat relevante në interes të organizatës
- Harton kartelën komunale investuese për qytetarë, në bashkëpunim me qytetarët, ku edhe finalizimi i saj bëhet në bashkëpunim me përfaqësuesit e NOPM-së
- Lehtëson në procesin e hartimit, ri-shikimit të ftesave dhe prezantimeve në PPT për punëtorit që duhet të organizohen për komunën partnere
- Mbikëqyrë rolin, identifikon dhe zhvillon mekanizma të kontrollit
- Kryen trajnime, koordinon dhe monitoron proceset e punëtorive (përgatitë listën e pjesëmarrësve, ftesat dhe agjendat, fotografitë, publikimet mediale, prezantimet në PPT

(dërgohen fillimisht tek zyrtarët e NOPM-së për aprovim), si dhe raporte ditore të takimeve/pas çdo aktiviteti

- Bën përgatitjen e moduleve trajnuese (nëse është e nevojshme)
- Kryen vizita në komunë me qëllim të njoftimit të procesit dhe lehtësimit të punës së tij/saj (nëse është e nevojshme).

Përveç shërbimeve të përmendura më lartë, asistenca teknike duhet të sigurohet si në vijim:

- Të siguroj trajnim në punë për përfituesit direkt të projektit;
- Të dokumentoj dhe të bëjë shkëmbimin e praktikave të mira të proceseve si dhe fushëveprimin e punës.

REZULTATET E PRITURA NGA KONSULENTI/TRAJNERI LOKAL

1. Komiteti Komunal për Iniciativa është i themeluar, aktiv dhe plani i veprimit është aprovuar, si mjet i verifikimit duhet të dërgohet dokumentet si në vijim:

1. Pregaditja e prezantimeve, materialeve për punëtorit sipas aktiviteteve
2. Moderimi dhe udhëheqja/prezentimi i punëtorive apo trajnimeve
3. Draftimin dhe finalizimin e planit të veprimit për komitetin/komisionin për iniciativë
4. Draftimin dhe finalizimin e planit të veprimit për komitetet konsultative
5. Hartimi dhe finalizimi i kartelave komunale investuese për qytetarë
6. Pregaditja e dokumente të tjera relevante, sipas nevojës, kërkesës së përfaqësuesve të NOPM-së

2. Ndërgjegjësimi i qytetarëve mbi demokracinë e drejtpërdrejtë, qeverisjen e hapur dhe pjesëmarrjen efektive në proceset e vendim-marrjes dhe politik bërjes është rritur dhe kapacitetet e komiteteve konsultative dhe këshillave të fshatrave janë ngritur, si mjet i verifikimit duhet të dërgohen si në vijim:

1. Raportet ditore dhe përfundimtare nga takimet publike mediale, si dhe dokumente të tjera relevante, sipas nevojës

3. Aktivitetet avokuese, pjesëmarrja në takime publike, konsultime publike dhe dialogu ndërmjet qytetarëve/shoqërisë civile dhe autoriteteve komunale është rritur, si mjet i verifikimit duhet të dërgohet si në vijim:

1. Hartimi dhe finalizimi i kartelave komunale investuese për qytetarë
2. ftesa dhe agjendat
3. prezantimet në PPT
4. fotografitë, publikimet mediale
5. raportet nga takimet, si dhe dokumentet të tjera relevante, sipas nevojës

4. Dorëzimi i raporteve ditore dhe finale **para dhe pas çdo aktiviteti** të paraparë (duke përfshirë, listën e pjesëmarrësve, ftesa dhe agjendat, prezantimet në PPT, fotografitë, publikimet mediale etj.

5. Raporti përfundimtar i përmbledhur me të gjitha aktivitetet

Detyrat, përgjegjësitë dhe rezultatet e pritura nga konsulenti/trajneri lokal të përshkruara më sipër janë të përcaktuara vetëm në terma të përgjithshme. Kjo mund të zgjatet dhe të rregullohen në bazë të nevojave dhe kërkesave që dalin nga fusha/terreni.

PROFILI I KONUSLENTIT/TRAJNERIT LOKAL

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Të posedoj fakultetin Bachelor, e preferueshme Master (Shkenca Sociale), në shkenca politike, administratë publike apo në fusha të ngjashme;
- Të flasë rrjedhshëm në gjuhën Shqipe, Serbe, dhe Angleze (raportimi bëhet në gjuhën Shqipe dhe/apo Angleze);
- Aftësi të mira kompjuterike (Paketa e Microsoft Office);
- Patent shoferi (Kategoria B)

Përvoja e përgjithshme:

- 3 vite përvojë në vetëqeverisje lokale, demokratizim dhe në reformat e administratës publike;
- E preferueshme përvoja në pozita të ngjashme me projekt(e) të financuar me donator të ndryshëm lokal dhe ndërkombëtarë;
- Përvojë në regjion dhe/apo në komunat e lindjes së Kosovës do të konsiderohet si përparësi.

Përvoja specifike:

- 3 vite përvojë pune në administratë komunale dhe/apo në projekte të ndryshme në vetëqeverisje lokale, respektivisht me projekte të ndryshme të politike bërjes me nivelin komunal (ekzekutivin dhe legjislativin)
- Përvojë në organizime, hartimin të dokumenteve pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe bërja avokime tek autoritet komunale për hartimin e politikave lokale
- Përvojë në lehtësimin e debateve dhe dëgjimeve publike
- Aftësi në ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve komunale në lidhje me pjesëmarrjen në vendim-marrje dhe politikë bërje.
- Përvojë të dëshmuar në programe trajnues në ofrimin e organizimeve, trajnimeve, prezantimeve për grupet e synuara direktet të projektit;
- Përvojë në një apo më shumë fusha si:
 - përvoja trajnues për autoritet komunale dhe grupe e synuara të projektit;
 - përgatitje në ngritje të kapaciteteve/mbikëqyrje, fasilitim të grupit të synuar të projektit;
 - përvojë në hartimin e dokumenteve të ndryshme relevante të projektit.

OJQ - NOPM ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë kandidatët dhe inkurajon të ofrohen propozime për konsulentë/trajnerë lokale femra, si dhe konsulentë/trajnerë lokale femra nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë.